<p>apo në ndonjë mënyrë tjetër të duhur. Ajo poashtu mund të mbajë seminare dhe të organizojë fushata për ngritje të vetëdijes kur kjo konsiderohet si e nevojshme.</p> <p>3. Agjencia për kryerjen e detyrave të saj mund të inkurajojë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së të dhënave me përfaqësues të shoqatave dhe organizatave tjera joqeveritare në fushën e mbrojtjes së të dhënave, privatësisë dhe mbrojtjes së konsumatorit.</p> <p style="text-align: center;"><b><u>Nënkreu G</u></b> <b>Inspektimet dhe Kontrollet</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 46</b> <b>Fushëveprimi i inspektimeve</b></p> <p>1. Agjencia me iniciativën e vet mund të kryejë inspektime dhe kontrole, për të mbikëqyrur pajtueshmërinë me rregullat e mbrojtjes së të dhënave. Në kuadër të kompetencave të inspektimit, Agjencia:</p> <p>1.1 mbikëqyrë ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale;</p> <p>1.2 mbikëqyrë përshtatshmërinë e</p>	<p>in any other way considered appropriate. It may also hold seminars and organize awareness raising campaigns as considered appropriate.</p> <p>3. The Agency may for the performance of its tasks encourage the cooperation with representatives of associations and other nongovernmental organizations in the area of data protection, privacy and consumer protection.</p> <p style="text-align: center;"><b><u>Subchapter G</u></b> <b>Inspections and audits</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 46</b> <b>Scope of inspections</b></p> <p>1. The Agency may carry out inspections and audits on its own initiative to monitor the compliance with data protection rules. Within the framework of inspection powers the Agency shall:</p> <p>1.1 monitor the legitimacy of data processing;</p> <p>1.2 monitor the suitability of</p>	<p>Ona, takode moze da odrzi seminare i kampanje za podizanje svesti kada se to smatra potrebnim</p> <p>3. Agencija, moze ohrabriti saradnju u oblast zastite licnih podataka sa predstavnicima nevladinih organizacija i drugih privatnih organizacija na zastitu potrosaca, radi izvrshavanja svojih zadataka</p> <p style="text-align: center;"><b><u>Podglavlje G</u></b> <b>Inspektovanja i Kontrole</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 46</b> <b>Delokrug rada inspektovanja</b></p> <p>1. Agencija, moze da izvrši inspektovanja i kontrole, na svoju inicijativu radi nadziranja usklađenosti sa propisima o zaštiti podataka. U okviru nadležnosti za inspektovanje Agencije:</p> <p>1.1 nadzirati zakonitost obrade licnih podataka;</p> <p>1.2 nadzirati usklađenost postupaka i</p>
---	--	---





<p>procedurave dhe masave të ndërmarra për sigurinë e të dhënave personale në pajtim me këtë Ligj;</p> <p>1.3 mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të këtij Ligji që rregullojnë katalogun e sistemit të dosjeve, regjistrin e sistemit të dosjeve dhe regjistrimet e zbulimit të të dhënave personale tek marrësit;</p> <p>1.4 mbikëqyrë zbatimin e dispozitave lidhur me transferimin e të dhënave personale tek shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 47</b> <b>Kryerja e drejtpërdrejtë e inspektimit</b></p> <p>1. Inspektimet dhe kontrollet duhet të kryhen drejtpërdrejt nga Mbikëqyrësit, brenda kufijve të kompetencave të tyre.</p> <p>2. Kur kryejnë inspektime dhe kontrolle Mbikëqyrësit duhet të identifikohen me kartelë zyrtare të identifikimit, e cila përmban fotografinë e Mbikëqyrësit, emrin(at) e tij personal, titullin profesional ose shkencor dhe të dhënat tjera të nevojshme.</p>	<p>procedures and measures taken for the protection of personal data pursuant to this Law;</p> <p>1.3 monitor the implementation of the provisions of this Law regulating the filing system catalogue, the register of filing systems and the recordings of the disclosures of personal data to recipients;</p> <p>1.4 monitor the implementation of provisions regarding the transfer of personal data to other countries and international organizations.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 47</b> <b>Direct performance of inspections</b></p> <p>1. Inspection and audits shall be carried out directly by the Supervisors within the limits of their competences.</p> <p>2. When carrying out inspections and audits the Supervisors shall identify themselves with an official identity card containing a photograph of the Supervisor, his or her personal name(s), professional or scientific title and other necessary information.</p>	<p>mera preduzetih za bezbednost ličnih podataka u skladu sa ovim Zakonom;</p> <p>1.3 nadzirati sprovođenje odredaba ovog Zakona koji reguliše sistem dosijea, registraciju sistema dosijea i registraciju otkrivanja ličnih podataka primaocima;</p> <p>1.4 nadzirati sprovođenje odredaba u vezi transfera ličnih podataka u druge države i međunarodne organizacije.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 47</b> <b>Neposredno izvršenje inspektovanja</b></p> <p>1. Inspektovanja i kontrole treba da se izvršavaju neposredno od nadzornika u okviru njegovih nadležnosti.</p> <p>2. Kada nadzornici izvršavaju inspektovanja i kontrole, isti reba da budu identifikovani službeom karticom za identifikaciju, koja treba da sadrži sliku nadzornika, njegovo lično ime, profesionalno naučno zvanje, kao i druge potrebne podatke.</p>
---	--	---



<p>3. Me propozim të Agjencisë, Qeveria e Kosovës me akt nënligjor lëshon kartelat zyrtare të identifikimit të Mbikëqyrësve si dhe përcakton në mënyrë të detajuar formën dhe përmbajtjen e tyre.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 48</b> <b>Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit</b></p> <p>1. Gjatë kryerjes së inspektimit dhe kontrollit, mbikëqyrësit kanë të drejtë të:</p> <p>1.1 kontrollojnë dhe konfiskojnë çdo dokumentacion që ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale, pavarësisht nga besueshmëria ose fshehtësia e tij, transferimin e të dhënave personale tek shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare si dhe me zbulimin për marrësit e jashtëm;</p> <p>1.2 kontrollojnë përmbajtjen e sistemeve të dosjeve, pavarësisht nga besueshmëria ose fshehtësia e tyre dhe katalogët e sistemit të dosjeve;</p> <p>1.3 kontrollojnë dhe konfiskojnë çdo dokumentacion dhe udhëzime që rregullojnë sigurinë e të dhënave</p>	<p>3. The Government of Kosovo shall issue the official identity cards of the Supervisors according to sub-legal act upon the proposal of the Agency detailing the format and the content of the cards.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 48</b> <b>Responsibility of the Supervisors</b></p> <p>1. In performing inspection and audits, the Supervisors shall be entitled:</p> <p>1.1 to examine and confiscate any documentation relating to the processing of personal data, irrespective of their confidentiality or secrecy, and the transfer of personal data to other countries and international organizations as well as the disclosure to foreign recipients;</p> <p>1.2 to examine the contents of filing systems, irrespective of their confidentiality or secrecy, and the filing system catalogues;</p> <p>1.3 to examine and confiscate any documentation and instructions regulating the security of personal</p>	<p>3. Na predlog Agencije, Vlada Kosova, podzakonskim aktom izdaje službene kartice identifikacije nadzornicima i utvrđuje na detaljan način njihov oblik i sadržaj.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 48</b> <b>Odgovornosti nadzornika</b></p> <p>1. Na izvršavanju inspektovanja i kontrole, nadzornik ima pravo da:</p> <p>1.1 kontrolišu i konfiskuju svaku dokumentaciju u vezi obrade ličnih podataka, nezavisno od njenih poverljivosti ili tajnosti, prenosom ličnih podataka kod drugih država i međunarodnih organizacija, kao i otkrivanjem za strane primaoce;</p> <p>1.2 kontrolišu sadržaj sistema dosijea, nezavisno od njihove poverljivosti ili tajnosti, kao i kataloge sistema dosijea;</p> <p>1.3 kontrolišu i konfiskuju svaku dokumentaciju i uputstvo koji regulišu bezbednost ličnih podataka;</p>
---	---	--



<p>personale;</p> <p>1.4 kontrollojnë ndërtesën në të cilën të dhënat personale përpunohen dhe kanë të drejtë të kontrollojnë dhe konfiskojnë kompjuterët dhe çfarëdo pajisje tjetër, si dhe dokumentacionin teknik;</p> <p>1.5 verifikojnë masat dhe procedurat që kanë për qëllim të sigurojnë të dhënat personale dhe zbatimin e tyre;</p> <p>1.6 kryejnë çdo detyrë tjetër që konsiderohet e rëndësishme për kryerjen e inspektimeve dhe kontrolleve të parapara me këtë Ligj.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 49</b> <b>Masat e inspektimit</b></p> <p>1. Nëse Mbikëqyrësi heton shkelje të këtij Ligji ose të cilido ligj apo rregulloreje që rregullon përpunimin e të dhënave personale, ai ose ajo kanë të drejtë që menjëherë:</p> <p>1.1 të urdhërojë eliminimin e parregullsive ose mangësive që ai ose</p>	<p>data;</p> <p>1.4 to examine premises in which personal data are supposed to be processed and they are entitled to examine and confiscate computers and any other equipment and technical documentation;</p> <p>1.5 to verify measures and procedures intended to secure personal data, and the implementation thereof;</p> <p>1.6 to perform any other matters considered necessary for the carrying out of inspections and audits as provided by this Law.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 49</b> <b>Inspection measures</b></p> <p>1. If a Supervisor detects a violation of this Law or any other law or regulation governing the processing of personal data he or she shall have the right to immediately:</p> <p>1.1 order the elimination of irregularities or deficiencies he or</p>	<p>1.4 kontroliše zgradu u koju se obrađuju lični podaci, imaju pravo da kontrolišu i konfiskuju računare i bilo koju drugu opremu, kao i tehničku dokumentaciju;</p> <p>1.5 proveriti mere i postupke koji imaju za cilj obezbeđenje ličnih podataka, i njihovu primenu;</p> <p>1.6 vrši druge zadatke koji se smatraju značajnim za izvršavanje inspektovanja i kontrole predviđenim ovim Zakonom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 49</b> <b>Mere inspektovanja</b></p> <p>1. Ako nadzornik primeti neku povredu ovog Zakona ili bilo kog drugog zakona ili pravilnika koji administrira obradu ličnih podataka, on ili ona imaće pravo da odmah:</p> <p>1.1 naredi eliminisanje nepravilnosti ili nedostatke koje on ili ona</p>
--	---	--



<p>ajo i heton, në mënyrën dhe brenda afatit të caktuar më parë nga ai ose ajo. Kjo mund të përfshijë asgjësimin, bllokimin, shkatërrimin, fshirjen ose anonimitetin e të dhënave personale aty ku konsiderohet e nevojshme.</p> <p>1.2 të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin e të dhënave personale nga kontrolluesit dhe përpunuesit në sektorët publik ose privat, të cilët kanë dështuar në zbatimin e masave dhe procedurave të nevojshme për sigurimin e të dhënave personale;</p> <p>1.3 të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin e të dhënave personale, anonimitetin e tyre, klasifikimin dhe bllokimin e të dhënave personale sa herë që ai ose ajo konkludon se të dhënat personale janë duke u përpunuar në kundërshtim me dispozitat ligjore;</p> <p>1.4 të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin e të dhënave personale në vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare, ose zbulimin e tyre marrësve të huaj nëse</p>	<p>she detects in the manner and within the terms he or she has previously defined. This may include the erasure, blocking, destruction, deletion or anonymity of data where considered necessary.</p> <p>1.2 impose a temporary or definite ban on the processing of personal data by controllers and processors in the public or private sectors who have failed to implement the necessary measures and procedures to secure personal data;</p> <p>1.3 impose a temporary or definite ban on the processing of personal data, their anonymity, classification and blocking whenever he or she concludes that the personal data are being processed in contravention of legal provisions;</p> <p>1.4 impose a temporary or definite ban on the transfer of personal data to other countries or international organizations, or their disclosure to foreign recipients if they are</p>	<p>primeçuje, na naçin i u okviru roka predviđenog od njega ili od nje. To obuhvaća uništenje, blokiranje, razaranje, brisanje ili anonimnitet ličnih podataka tamo gde se smatra potrebnim</p> <p>1.2 privremeno zabrani i na uredan naçin obradu ličnih podataka od strane kontrolora i prerađivača podataka u javnom ili privatnom sektoru koji su otkazali sprovođenje potrebnih mera i postupaka za obezbeđenje ličnih podataka;</p> <p>1.3 nmeće privremeni prekid obrade ličnih podataka, njihovu anonimizaciju, klasifikaciju i blokiranje ličnih podataka, kad god on ili ona dolazi do zaključka da lični podaci su u toku obrade suprotno zakonskim odredbama;</p> <p>1.4 nameće privremeni prekid prenosa ličnih podataka u druge zemlje i međunarodne organizacije, ili njihvo otkrivanje stranim primaocima, ako isti su prenošeni ili</p>
--	---	--



<p>ato janë transferuar ose zbuluar në kundërshtim me dispozitat ligjore ose me traktatet ndërkombëtare detyruese;</p> <p>1.5 të paralajmërojë ose këshillojë me shkrim kontrolluesin e të dhënave ose përpunuesin e të dhënave në rastet e shkeljeve të vogla.</p> <p>2. Në rast të parregullsive ose mangësive kontrolluesi i të dhënave ose përpunuesi i të dhënave duhet që menjëherë t'i korrigjojë ato pas marrjes së udhëzimeve me shkrim ose këshillimit nga Mbikëqyrësi për të siguruar përpunim të ligjshëm të të dhënave.</p> <p>3. Nëse ekziston dyshim i bazuar se është kryer veprë penale apo kundërvajtje Mbikëqyrësi bën kallëzim penal sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës apo vepron në pajtim me ligjin për kundërvajtjet.</p> <p>4. Kundër vendimit përfundimtar të Mbikëqyrësit nga paragrafi 1 të këtij neni, nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikti administrativ në Gjykatën kompetente.</p>	<p>transferred or disclosed in contravention of legal provisions or binding international treaties;</p> <p>1.5 in minor cases of violations the Supervisor can warn or admonish the data controller or data processor in writing.</p> <p>2. In case of irregularities or deficiencies the data controller or data processor shall immediately correct them by following the written instructions or advice of the Supervisor to ensure lawful data processing.</p> <p>3. If there are plausible reasons to suspect that a criminal offence or a minor offence has been committed the Supervisor shall file a criminal notification pursuant to the Criminal Procedural Code of Kosovo or implement a procedure in accordance with the law regulating minor offences.</p> <p>4. There shall be no appeal against a final decision of the Supervisor from paragraph 1 of this Article, but an administrative dispute shall be permitted in the competent Court.</p>	<p>su poznati suprotno obaveznim statutarnim odredbama ili važećim međunarodnim sporazumima;</p> <p>1.5 u slučajevima malih povreda, nadzornik može da pismeno obaveštava ili posavetuje kontrolora podataka ili prerađivača podataka.</p> <p>2. U slučaju nepravilnosti ili mana, kontrolor ili obrađivač podataka, treba odmah da ih koriguje nakon prijema pismenih uputstava ili saveta od Nadzornika, radi obezbeđenja zakonite obrade podataka.</p> <p>3. Ako postoji osnovana sumnja da je izvršeno krivično delo ili prekršaj, Nadzornik prijavi optužbu za krivično delo prema Zakoniku o krivičnom postupku Kosova ili postupa prema Zakonu o prekršajima.</p> <p>4. Na konačnu odluku Nadzornika iz stava 1, ovog člana, ne dozvoljava se prigovor ali može da se pokrene administrativni spor pri nadležnom sudu.</p>
---	---	---



<p style="text-align: center;"><b>Neni 50</b> <b>Mbrojtja e fshehtësisë</b></p> <p>1. Mbikëqyrësit janë të obliguar që të mbrojnë fshehtësinë e të dhënave personale që hasin gjatë kryerjes së detyrave të tyre, si dhe pas ndërprerjes së ushtrimit të detyrave të tyre.</p> <p>2. Obligimi nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohet po ashtu ndaj të gjithë punëtorëve të tjerë që punojnë në Agjenci.</p> <p><b>KREU V</b></p> <p><b>TRANSFERIMI I TË DHËNAVE PERSONALE</b></p> <p style="text-align: center;"><b><u>Nënkreu H</u></b> <b>Transferimi i të dhënave personale tek shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 51</b> <b>Dispozitat e përgjithshme</b></p> <p>Transferimi të dhënave personale të cilat</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 50</b> <b>Protection of confidentiality</b></p> <p>1. The Supervisors shall be obliged to protect the confidentiality of personal data they encounter in performing their tasks also after ceasing to perform their duties.</p> <p>2. The obligation from paragraph 1 of this Article shall also apply to the other members working at the Agency.</p> <p><b>CHAPTER V</b></p> <p><b>TRANSFER OF PERSONAL DATA</b></p> <p style="text-align: center;"><b><u>Subchapter H</u></b> <b>Transfer of personal data to other Countries and international organizations</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 51</b> <b>General provisions</b></p> <p>The transfer to other countries and</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 50</b> <b>Zaštita tajne</b></p> <p>1. Nadzornici su obavezni da zaštite tajnu ličnih podataka na koje nailaze prilikom vršenja njihovog rada, kao i nakon obavljanja njihovih zadataka.</p> <p>2. Obaveza iz stava 1 ovog člana, takođe se primenjuje i na sve druge članove koji rade u Agenciji.</p> <p><b>POGLAVLJE V</b></p> <p><b>PRENOS LIČNIH PODATAKA</b></p> <p style="text-align: center;"><b><u>Podglavlje H</u></b> <b>Prenos ličnih podataka kod drugih država i međunarodnih organizacija</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 51</b> <b>Opšte odredbe</b></p> <p>1. Transfer ličnih podataka koji su obrađeni ili se nameravaju da se obrade, u drugim</p>
---	--	--



<p>janë përpunuar ose ato që do të përpunohen në vende të tjera dhe tek organizatat ndërkombëtare, mund të bëhet vetëm në pajtim me dispozitat e këtij Ligji dhe në qoftë se vendi ose organizata ndërkombëtare në fjalë sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave.</p>	<p>international organizations of personal data that are processed or are intended to be processed after transfer may take place only in accordance with the provisions of this Law and if the country or the international organization in question ensures an adequate level of data protection.</p>	<p>zemljama i međunarodnim organizacijama, može da se obavi samo uz saglasnost sa odredbama ovog Zakona i ako pomenuta zemlja ili međunarodna organizacija obezbeđuje potreban nivo zaštite podataka.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 52</b> <b>Procedura për përcaktimin e nivelit të duhur për mbrojtjen e të dhënave personale</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 52</b> <b>Procedure for determining an adequate level of data protection</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 52</b> <b>Postupak za određivanje potrebnog nivoa zaštite ličnih podataka</b></p>
<p>1. Vendet dhe organizatat ndërkombëtare konsiderohen se sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave, nëse Agjencia ka marrë një vendim formal, dhe ato vende apo organizata janë përfshirë në listën përkatëse të nxjerrë nga Agjencia në pajtim me këtë Ligj.</p>	<p>1. Countries and international organizations are considered as ensuring an adequate level of data protection if the Agency has taken a formal decision and they are included in the respective list established by the Agency in accordance with this Law.</p>	<p>1. Zemlje i međunarodne organizacije smatraju se, da su toku obezbeđenja potrebnog nivoa zaštite ličnih podataka, ako Agencija je doneo formalnu odluku, i one zemlje ili organizacije su uključene na odgovarajućoj listi sastavljene od Agencija u skladu sa ovim Zakonom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 53</b> <b>Lista e vendeve dhe organizatave ndërkombëtare me nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 53</b> <b>List of countries and international organizations with an adequate level of data protection</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 53</b> <b>Lista zemalja i međunarodnih organizacija sa potrebnim nivoom zaštite podataka</b></p>



<p>1. Agjencia mban një listë të vendeve dhe të organizatave ndërkombëtare për të cilat ajo konstaton se ato sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave, në pajtim me këtë Ligj.</p> <p>2. Lista mund të përmbajë Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Zonës Ekonomike Evropiane. Ndërsa sa i përket vendeve të tjera Agjencia mund të zbatojë vendimet e marra nga organi kompetent i Bashkimit Evropian nëse vendet e tilla dhe organizatat ndërkombëtare sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave, ose mund të merr një vendim formal sipas nenit 54 të këtij Ligji.</p> <p>3. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror publikon listën nga paragrafi 1 i këtij neni në Gazetën Zyrtare dhe faqen publike të tij.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 54</b> <b>Vendimet për nivelin e duhur të mbrojtjes së të dhënave nga vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare</b></p> <p>1. Gjatë marrjes së vendimit të tij lidhur me nivelin e duhur të mbrojtjes së të dhënave personale të një vendi tjetër ose organizate ndërkombëtare, Agjencia detyrohet t'i</p>	<p>1. The Agency shall maintain a list of countries and international organizations for which it finds that they ensure an adequate level of data protection in the meaning of this Law</p> <p>2. The list can contain the Member States of the European Union and the European Economic Area. As to other countries the Agency can take over any decisions taken by the competent body of the European Union as to whether such countries and international organizations ensure an adequate level of data protection or it can take a formal decision according to Article 54 of this Law.</p> <p>3. The Chief National Supervisor shall publish the list from paragraph 1 of this Article in the Official Gazette and on its website.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 54</b> <b>Decisions on the adequate level of data protection of other countries and international organizations</b></p> <p>1. In its decision-making on the adequate level of protection of personal data of another country or an international organization, the Agency shall determine</p>	<p>1. Agjencia vodi listu zemalja i međunarodnih organizacija za koje ona utvrdi da iste obezbeđuju potreban nivo zaštite podataka u skladu sa ovim Zakonom.</p> <p>2. Lista može da sadrži zemlje članice Evropske zajednice i Evropske ekonomske zone. A što se tiče drugih zemalja Agencija može da primeni donošene odluke od nadležnog organa EZ-a, ako takve zemlje i međunarodne organizacije obezbeđuju potreban nivo zaštite podataka, ili može da donosi formalnu odluku u skladu sa članom 54 ovog Zakona.</p> <p>3. Glavni državni nadzornik će objaviti listu iz stava 1 ovog člana u Službenom listu i u njegovu veb stranu.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 54</b> <b>Odluke o pristupačnim nivou zaštite podataka drugih zemalja i međunarodnih organizacija.</b></p> <p>1. Na osnovu njegove donošene odluke o potrebnom nivou zaštite ličnih podataka u nekoj drugoj zemlji ili međunarodnoj organizaciji, Agencija će biti primoren da</p>
---	--	--





<p>përcaktojë të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me transferimin e të dhënave personale. Në veçanti, ajo merr parasysh llojin e të dhënave personale, qëllimin dhe kohëzgjatjen e përpunimit të propozuar, rregullimin ligjor në vendin e origjinës dhe në vendin e marrësit, duke përfshirë rregullimin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve të huaj, si dhe masat për sigurimin e të dhënave personale të përdorura në vendet e tilla dhe organizatat ndërkombëtare.</p> <p>2. Gjatë marrjes së vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, Agjencia në veçanti merr parasysh:</p> <p>2.1 nëse të dhënat personale të transferuara janë përdorur vetëm për qëllimin për të cilin ato janë transferuar, ose nëse qëllimi mund të ndryshojë vetëm në bazë të lejes së kontrolluesit të të dhënave që i siguron të dhënat apo në bazë të pëlqimit personal të subjektit të të dhënave;</p> <p>2.2 nëse subjekti i të dhënave ka mundësi të përcaktojë qëllimin për të cilin të dhënat personale të tij ose saj janë përdorur, kujt i janë dërguar ato</p>	<p>all circumstances relating to the transfer of personal data. In particular, it shall take account of the type of personal data, the purpose and duration of the proposed processing, the legal arrangement in the country of origin and the recipient country, including legal arrangement for protection of personal data of foreign citizens, and measures to secure personal data used in such countries and international organizations.</p> <p>2. In its decision-making from paragraph 1 of this Article the Agency shall in particular take account of:</p> <p>2.1 whether the transferred personal data are used solely for the purpose for which they were transferred, or whether the purpose may change only on the basis of a permission of the data controller supplying the data or on the basis of personal consent of the data subject;</p> <p>2.2 whether the data subject has the possibility of determining the purpose for which his or her personal data have been used, to</p>	<p>odredi sve okolnosti što se tiče prenosa ličnih podataka. Ona na poseban način će biti obavezan da uzima u obzir vrstu ličnih podataka, namenu i vreme trajanja predložene obrade, zakonski sporazum u zemlji porekla i zemlji primalaca, uključujući zakonsko regulisanje zaštite ličnih podataka stranih građana, kao i mere radi obezbeđenja ličnih podataka upotrebljenih u takvim zemljama i međunarodnim organizacijama.</p> <p>2. Za odlučivanje iz stava 1, ovog člana, Agencija posebno će uzeti u obzir:</p> <p>2.1 ako prenešeni lični podaci su upotrebljeni samo za namenu za koju su prenešeni, ili ako namena može da se izmeni samo na osnovu dozvole kontrolora podataka koji snabdeva ličnim podacima ili na osnovu lične saglasnosti subjekta podataka na koga se odnose lični podaci;</p> <p>2.2 Ako subjekat podataka na koga se odnose lični podaci, ima mogućnost da odredi cilja za koga su upotrebljeni njegovi ili njeni lični</p>
--	---	---



<p>dhe mundësinë e korigjimit ose asgjësimit së të dhënave personale të pasakta apo te vjetërsuara , përveç në rastet kur kjo është e ndaluar me marrëveshje ndërkombëtare detyruese për shkak të fshehtësisë së procedurës;</p> <p>2.3 nëse kontrolluesi ose përpunuesi i huaj i të dhënave përmbush procedurat dhe masat e duhura organizative dhe teknike për mbrojtjen e të dhënave personale;</p> <p>2.4 nëse është caktuar personi kontaktues i autorizuar për ofrimin e informatave subjektit të të dhënave ose Agjencisë për përpunimin e të dhënave personale të transferuara;</p> <p>2.5 nëse marrësi i huaj i të dhënave mund të transferojë të dhënat personale vetëm me kusht që marrësi tjetër i huaj i të dhënave të cilit i zbulohen të dhënat siguron një mbrojtje të duhur të të dhënave personale edhe për shtetasit e huaj;</p> <p>2.6 nëse është siguruar mbrojtje</p>	<p>whom they were supplied and the possibility of correcting or erasing inaccurate or outdated personal data, unless this is prevented due to the secrecy of the procedure by binding international treaties;</p> <p>2.3 whether the foreign data controller or data processor performs adequate organizational and technical procedures and measures to protect personal data;</p> <p>2.4 whether there is an assigned contact person authorized to provide information to the data subject or to the Agency on the processing of personal data transferred;</p> <p>2.5 whether the foreign data recipient may transfer personal data only on the condition that another foreign data recipient to whom personal data will be disclosed ensures adequate protection of personal data also for foreign citizens;</p> <p>2.6 whether provide legal protection</p>	<p>podaci, kome su upućeni i mogućnost korekcije ili uništenja netačnih ili zastarelih ličnih podataka, osim slučajeva kada je to zabranjeno međunarodnim sporazumima obavezujući zbog razloga tajne;</p> <p>2.3 ako strani kontrolor podataka izvršava potrebne organizacione i tehničke postupke i mere za zaštitu ličnih podataka;</p> <p>2.4 ako ima nekog lica određenog za ovlašćeni kontakt radi pružanja informacije subjektu podataka na koga se odnose lični podaci, ili Agenciji za obrade i prenošene lične podatke;</p> <p>2.5 ako strani primalac podataka može da transferiše lične podatke samo pod uslovima, da drugi strani primalac kome se otkrivaju lični podaci, obezbedi potrebnu zaštitu ličnih podataka i za strane državljane;</p> <p>2.6 ukoliko je obezbeđena zakonska</p>
---	--	--



<p>ligjore efektive për subjektet e të dhënave të dhënat personale të të cilëve janë transferuar apo do të transferohen.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 55</b> <b>Kriteret për Vendimmarrje</b></p> <p>Agjencia përcakton në mënyrë të detajuar se cili informacion është i domosdoshëm për të vendosur nëse shteti tjetër ose organizata ndërkombëtare siguron nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale, siç është paraparë me këtë Ligj.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 56</b> <b>Dispozitat e veçanta</b></p> <p>1. Pavarësisht nga neni 51 i këtij Ligji, të dhënat personale mund t'i transferohen dhe zbulohen vendit ose organizatës ndërkombëtare që nuk e siguron nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave, nëse:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1 është paraparë me ligj tjetër ose me marrëveshje ndërkombëtare detyruese;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2 subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij ose të saj dhe është i vetëdijshëm për pasojat e</p>	<p>is ensured for data subjects whose personal data were or are to be transferred.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 55</b> <b>Criteria for Decision Making</b></p> <p>The Agency defines in greater detail which information is necessary to decide whether another country or an international organization provides an adequate level of data protection in the meaning of this Law.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 56</b> <b>Special provisions</b></p> <p>1. Irrespective of Article 51 of this Law, personal data may be transferred and disclosed to a country or international organizations not ensuring an adequate level of data protection , if:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1 so provided by another law or binding international treaty;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2 the data subject has given his or her consent and is aware of the consequences of the transfer;</p>	<p>efektivna zaštita subjektepodataka čiji lični podaci su transferisani ili će se transferisati.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 55</b> <b>Kriterjumi za odlučivanje</b></p> <p>Agencija utvrdi načina, o proceni koja infomarcija je neophodna za odlučivanje ako druga država ili međunarodna organizacija obezbeđuje potreban nivo zaštite ličnih podataka shodno ovim Zakonom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 56</b> <b>Posebne odredbe</b></p> <p>1. Nezavisno od član 51, ovog Zakona, lični podaci mogu se transferisati i otkrivati zemljama ili međunarodnim organizacijama koje ne obezbeđuju potreban nivo zaštite ličnih podataka, ako:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1 se obezbeđuje drugim zakonom ili drugim obavezujućim međunaronim sporazumom;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2 subjekat podataka je dao svoju ličnu saglasnost i svestan je posledicama takvog prenosa;</p>
---	---	---



<p>transferimit;</p> <p>1.3 transferimi është i nevojshme për përmbushjen e kontratës ndërmjet subjektit të të dhënave dhe kontrolluesit të të dhënave ose për zbatimin e masave para-kontraktuese të ndërmarra si përgjigje të kërkesës së subjektit të të dhënave;</p> <p>1.4 transferimi është i domosdoshëm për lidhjen ose përmbushjen e një kontrate, të lidhur për interes të subjektit të të dhënave ndërmjet kontrolluesit të të dhënave dhe një pale të tretë;</p> <p>1.5 transferimi është i domosdoshëm ose ai kërkohet sipas ligjit në bazë të rëndësisë së interesit publik;</p> <p>1.6 transferimi është i domosdoshëm për të mbrojtur jetën dhe trupin e subjektit të të dhënave;</p> <p>1.7 transferimi është i domosdoshëm për themelimin, ushtrimin ose mbrojtjen e kërkesave ligjore;</p> <p>1.8 transferimi është kryer nga një regjistër i cili në sipas ligjeve apo</p>	<p>1.3 the transfer is necessary for the performance of a contract between the data subject and the data controller or for the implementation of pre-contractual measures taken in response to the data subject's requests;</p> <p>1.4 the transfer is necessary for the conclusion or performance of a contract concluded in the data subject's interests between the data controller and a third party;</p> <p>1.5 the transfer is necessary or legally required on important public interest grounds;</p> <p>1.6 the transfer is necessary to protect the life and body of the data subject;</p> <p>1.7 the transfer is necessary for the establishment, exercise or defense of legal claims;</p> <p>1.8 the transfer is made from a register which according to laws or</p>	<p>1.3 prenos je potreban za ispunjenje ugovornih uslova među subjekta podataka i kontrolora podataka za sprovođenje predugovornih mera preduzetih za odgovor zahteva subjekta podataka;</p> <p>1.4 prenos je potreban za sklapanje ili ispunjenje ugovorenih uslova među kontrolora podataka i neke treće stranke za račun subjekta podataka;</p> <p>1.5 prenos je potreban ili zahtevan na zakonit način za značajnu bazu podataka od javnog interesa;</p> <p>1.6 prenos je potreban radi zaštite života i tela subjekta podataka;</p> <p>1.7 transfer je neophodan radi osnivanja, vršenja ili zaštite zakonitih zahteva;</p> <p>1.8 prenos je obavljen iz jednog registra koji u skladu sa zakonima</p>
--	---	---



rregulloreve ka për qëllim të informojë publikun dhe i cili është i hapur për konsultime qoftë nga publiku në përgjithësi ose nga çdo person i cili mund të shprehë një interes legjitim, për aq sa kushtet e përcaktuara për konsultim në këtë rast të veçantë janë përmbushur.

#### **Neni 57**

#### **Autorizimi për transferimin e të dhënave**

1. Pavarësisht nga Neni 51 i këtij Ligji Agjencia mund të autorizojë një transferim ose një sërë transferimesh të të dhënave personale në shtetin tjetër ose një organizatë ndërkombëtare e cila nuk siguron një nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave sipas këtij Ligji, në rastet ku kontrolluesi i të dhënave paraqet masat e duhura mbrojtëse për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtave dhe lirive themelore të individëve, sa i përket ushtrimit të të drejtave përkatëse. Masat e tilla mbrojtëse në veçanti mund të rezultojnë nga dispozitat e kontratës ose nga kushtet e përgjithshme të aktiviteteve biznesore që administrojnë transferimin e të

regulations is intended to provide information to the public and which is open to consultation either by the public in general or by any person who can demonstrate a legitimate interest, to the extent that the conditions laid down for consultation are fulfilled in this particular case.

#### **Article 57**

#### **Authorization for data transfers**

1. Without prejudice to Article 51 of this Law the Agency may authorize a transfer or a set of transfers of personal data to another country or an international organization not ensuring an adequate level of data protection within the meaning of this Law where the data controller adduces adequate safeguards for the protection of personal data and the fundamental rights and freedoms of individuals as regards the exercise of adduces rights. Such safeguards may in particular result from the provisions of the contract or the general terms of business activities governing the transfer of

ili pravilnicima ima za cilj da pruža informaciju javnosti, koja je otvorena za konsultaciju ili u opšte od javnosti ili od svakog lica koji može da pokazuje zakonski interes, pod određenim uslovima za konsultacije, u tom posebnom slučaju su ispunjeni do potrebnog nivoa.

#### **Član 57**

#### **Ovlašćenje za transfer podataka**

1. Nezavisno od člana 51 ovog Zakona, Agencija može de ovlasti prenos ili niz prenosa ličnih podataka nekoj drugoj zemlji ili međunarodnoj organizaciji koje ne obezbeđuje potreban nivo zaštite u smislu ovog Zakona. U slučajevima, kada komntrolor podataka postavlja potrebne zaštitne mere za zaštitu ličnih podataka, osnovnih prava i sloboda lica što se tiče ostvarivanja odgovarajućih prava. Takve zaštitne mere mogu da rezultiraju posebno od ugovornih odredaba ili od opštih uslova aktivnosti biznisa koji upravljaju trasferom ličnih podataka.



<p>dhënave personale.</p> <p>2. Kontrolluesi i të dhënave mund të transferojë të dhënat personale vetëm pas marrjes së autorizimit sipas paragrafit 1 të këtij neni. Me kërkesën e tij ose saj për autorizim, kontrolluesi i të dhënave i siguron Agjencisë informacionet e domosdoshme lidhur me transferimin e dëshiruar të të dhënave personale. Kjo në veçanti përfshin kategoritë e të dhënave, qëllimin e transferimit dhe masat mbrojtëse në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale në vendin tjetër apo organizatën ndërkombëtare.</p> <p>3. Agjencia vendosë për kërkesën nga paragrafi 2 i këtij neni pa vonesë dhe përshkruan me një akt nënligjor detajet dhe procedurat e brendshme për paraqitjen e kërkesave të tilla. Vendimi i lartëcekur është përfundimtar në procedurën administrative por mund të hapet konflikti administrativ në gjykatën kompetente.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 58</b> <b>Regjistrimi i autorizimeve</b></p> <p>Autorizimet lidhur me transferimin e të</p>	<p>personal data.</p> <p>2. The data controller may transfer personal data only upon receipt of the authorization according to paragraph 1 of this Article. In his or her request for authorization the data controller shall provide the Agency with all information necessary regarding the intended transfer of personal data. This includes in particular the categories of data, the purpose of the transfer and the safeguards in place for the protection of personal data in the other country or international organization.</p> <p>3. The Agency shall decide on the application from paragraph 2 of this Article without delay and shall describe in a sub-legal act the details and internal procedures for filing such requests. The above mentioned decision is final in administrative procedure but an administrative dispute shall be permitted in the competent court.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 58</b> <b>Registration of authorizations</b></p> <p>The authorizations concerning the transfer</p>	<p>2. Kontrolor podataka može da prenosi lične podatke, samo nakon uzimanja ovlašćenja shodno stavu 1 ovog člana. Na njegov ili njen zahtev za dobijanje ovlašćenje, kontrolor podataka, obezbeđuje Agencija neophodne informacije u vezi željenog transfera ličnih podataka. To, posebno, obuhvata kategorije podataka, cilj transfera i važeće zaštitne mere za zaštitu ličnih podataka u drugoj zemlji ili međunarodnu organizaciju.</p> <p>3. Agencija neodložno odlučuje u vezi zahteva iz stava 2 ovog člana i opisuje podzakonskim aktom pojedinosti i interne postupke za podnošenje takvih zahteva. Pomenuta odluka je konačna u administrativnom postupku, ali može da se pokrene administrativni spor pri nadležnom sudu.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 58</b> <b>Registracija ovlašćenja</b></p> <p>Ovlašćenja u vezi prenosa ličnih podataka</p>
--	---	--



<p>dhënave personale në vendin tjetër apo organizatën ndërkombëtare, të dhëna nga Agjencia duhet të regjistrohen në pajtim me pikën 10 të paragrafit 1 të Nenit 17 të këtij Ligji.</p>	<p>of personal data to another country or international organization granted by the Agency shall be registered in accordance with point 10 of paragraph 1 of Article 17 of this Law.</p>	<p>kod neke druge države ili međunarodne organizacije, izdatih od Agencije treba da se registruju u skladu tačke 10, stava 1, člana 17 ovog Zakona.</p>
<p><b>KREU VI</b></p>	<p><b>CHAPTER VI</b></p>	<p><b>POGLAVLJE VI</b></p>
<p><b>TË DREJTAT DHE MBIKËQYRJA</b></p>	<p><b>RIGHTS AND SUPERVISION</b></p>	<p><b>PRAVA I NADZOR ILI DOPUNSKE ODREDBE</b></p>
<p><b><u>Nënkreu I</u></b> <b>Marketingu i drejtpërdrejt</b></p>	<p><b><u>Subchapter I</u></b> <b>Direct marketing</b></p>	<p><b><u>Podglavlje I</u></b> <b>Neposredni marketing</b></p>
<p><b>Neni 59</b> <b>Të drejtat dhe përgjegjësitë e kontrolluesve të të dhënave</b></p>	<p><b>Article 59</b> <b>Rights and responsibilities of data controllers</b></p>	<p><b>Član 59</b> <b>Prava i odgovornosti kontrolora podataka</b></p>
<p>1. Kontrolluesit e të dhënave mund të përdorin të dhënat personale që ata i kanë siguruar nga burimet publike të qasshme ose brenda kufijve të kryerjes së ligjshme të aktiviteteve për qëllime të ofrimit të mallrave, shërbimeve, punësimit ose kryerjes së përkohshme të punës përmes përdorimit të shërbimeve postare, thirrjeve telefonike, postës elektronike ose mënyrave tjera të telekomunikimit (më tutje në tekst:</p>	<p>1. Data controllers may use personal data they obtained from publicly accessible sources or within the framework of the lawful performance of activities for the purposes of offering goods, services, employment or temporary performance of work through the use of postal services, telephone calls, electronic mail or other telecommunications means (hereinafter: direct marketing) in accordance with the</p>	<p>1. Kontrolor podataka može da upotrebi lične podatke koje on ili ona je uzeo od javnih pristupačnih izvora ili u okviru zakonskog vršenja aktivnosti, za potrebe ponudivanja roba, usluga, zapošljavanja ili privremenog obavljanja poslova, preko upotrebe poštanskih usluga, telefonskih poziva, elektronske pošte ili drugih načina telekomunikacije (u daljem tekstu: neposredni marketing) u skladu sa</p>



<p>marketingu i drejtpërdrejtë) në pajtim me dispozitat e këtij kreu, përveç nëse me ligjin përkatës është paraparë ndryshe.</p> <p>2. Për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, kontrolluesit e të dhënave mund të përdorin vetëm të dhënat personale në vijim të grumbulluara në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni: emrin(at) personal, adresën e vendbanimit të përhershëm ose të përkohshëm, numrin e telefonit, adresën e postës elektronike (e-mail) dhe numrin e faksit. Në bazë të pëlqimit paraprak të subjektit të të dhënave, kontrolluesit e të dhënave mund të përpunojnë të dhëna personale tjera, por të dhënat personale të ndjeshme mund t'i përpunojnë vetëm nëse ata e posedojnë pëlqimin e qartë të subjektit siç është pëlqimi me shkrim.</p> <p>3. Kur kryejnë marketing të drejtpërdrejtë, kontrolluesit e të dhënave duhet t'i informojnë subjektet e të dhënave për të drejtat e tyre sipas nenit 60 të këtij Ligji.</p> <p>4. Nëse kontrolluesit e të dhënave kanë për qëllim të zbulojnë të dhëna personale nga paragrafi 2 i këtij neni, tek marrësit e tjerë të të dhënave, për qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë, ose tek përpunuesit e të</p>	<p>provisions of this Chapter, unless otherwise provided by relevant law.</p> <p>2. For the purposes of direct marketing, data controllers may use only the following personal data collected in accordance with paragraph 1 of this Article: personal name(s), permanent or temporary address, telephone number, e-mail address and fax number. Based on the data subject's prior consent data controllers may process other personal data but may only process personal sensitive data if they possess the data subject's explicit consent such as in writing.</p> <p>3. When doing direct marketing data controllers must inform data subjects of their rights according Article 60 of this Law.</p> <p>4. If data controllers intend to disclose personal data from paragraph 2 of this Article to other data recipients for the purposes of direct marketing or to data</p>	<p>odredbama ovog poglavlja, dok se ne reguliše drugčije eakim odgovarajućim zakonom.</p> <p>2. Za potrebe neposrednog marketinga, kontrolori podataka može da upotrebi samo sledeće lične podatke prikupljenih u skladu sa stavom 1 ovog člana: lično(na) ime (na), adresu stalnog ili privremenog boravka, broj telefona, adresu elektronske pošte (i-mel adresu) i broj telefaksa. Na osnovu prethodne saglasnsoti subjekta podataka, kontrolori podataka može da obradi i druge lične podatke, ali može da obradi samo osetljive lične podatke ako on ili ona ima eksplicitnu pismenu saglasnost subjekata .</p> <p>3. Kada vrši neposredni marketing, kontrolor podataka treba da informiše subjekte podataka u vezi njihovih prava shodno članu 60 ovog Zakona.</p> <p>4. Ako kontrolor podataka ima za cilj otkrivanje ličnih podataka iz stava 2 ovog člana drugim primaocima podataka za potrebe neposrednog marketinga ili prerađivačima podataka, oni su dužni da</p>
---	--	--





<p>dhënave, ata janë të detyruar që të informojnë subjektin e të dhënave dhe të marrin pëlqimin me shkrim të tij ose të saj para se të zbulohen të dhënat e tilla. Njoftimi për subjektin e të dhënave lidhur me zbulimin në fjalë duhet të përmbajë të gjitha informacionet që synohen të zbulohen si dhe, kujt dhe për çfarë qëllimi. Shpenzimet e njoftimit mbulohen nga kontrolluesi i të dhënave.</p>	<p>processors, they shall inform the data subject and get his or her written consent before disclosing such data. The notification of the data subject regarding the intended disclosure must contain all information that is intended to be disclosed as well as to whom and for what purposes. The costs of notification shall be borne by the data controller.</p>	<p>informiшу subjekta podataka i da dobijaju pismenu saglasnost od njega ili od nje pre nego se otkriju podaci. Obaveštenje za subjekta podataka u vezi pomenutog prenosa treba da sadrži, sve podatke koje se nameravaju da se otkriju, kao i kome i za koji cilj. Troškovi obaveštenja pokrivaju se od kontrolora podataka.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 60</b> <b>E drejta për kundërshtim</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 60</b> <b>Right to object</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 60</b> <b>Pravo na prigovor</b></p>
